



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
Drejtoria e Prokurimeve

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Korçë më, 28.09.2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

*Date 28.09.2022*

Drejtuar: *Shoqërisë “NIKA”sh.p.k si përfaqësuese e bashkimit të operatorëve “NIKA”sh.p.k dhe “NDERTUESI 2014” sh.p.k, adresa e shoqërisë përfaqësuese: Shkodër, Lagj.Vasil Shanto, Bul. Skënderbeu, godinë 8 kateshe, kati i parë, zona kadastrale 8593, nr. Pasurie 5/587*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës **REF-39220-08-18-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **“Ndërhyrja për shmangien e përmbytjeve dhe erozionit në Bashkinë Korçë”**

Afati: **3 muaj nga data e lidhjes te kontrates**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike : **Date 22.08.2022, Nr.114**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Bashkimi i operatoreve “NIKA”sh.p.k, NIPT J76705047U & “NDERTUESI 2014”sh.p.k, NIPT L46827004L**

**me vleren:**

34.381.007,30 ( *tridhjetë e katër milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatë, presje tridhjetë* ) lekë, pa tvsh.

**2. Bashkimi i operatoreve “Xhengo”sh.p.k, NIPT J64103171M & “BE - IS”sh.p.k, NIPT K71412003A**

**me vleren:**

38.308.431,00 ( *tridhjetë e tetë milion e treqind e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e një* ) lekë, pa tvsh.

- 3. Bashkimi i operatoreve “Glavenica”shpk, NIPT K17710805A & “Ed Konstruksion”shpk, NIPT K61625001I me vleren:**  
39.787.314,00 ( *tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e katërmëdhjetë* )  
*lekë, pa tvsh.*
- 4. Shoqëria “Salillari ” shpk, NIPT J62903125G me vlerën:**  
40.827.181,50 ( *dyzet milion e tetëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një, presje pesëdhjetë* )  
*lekë pa tvsh.*
- 5. Bashkimi i operatoreve “Ina ” shpk, NIPT J61814009W & “2N” shpk NIPT L31615017L me vleren:**  
42.931.387 ( *dyzet e dy milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë* ) *lekë pa tvsh.*
- 6. Bashkimi i operatoreve “Infinit ”shpk, NIPT J74304623M & “Sireta 2F”shpk, NIPT K51501008J me vleren:**  
44.082.497,55 ( *dyzet e katër milion e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë, presje pesëdhjetë e pesë* ) *lekë, pa tvsh.*
- 7. Bashkimi i operatoreve “Denis 05”shpk, NIPT K51518029B & “Eurokos Holding”shpk, NIPT K91727010A me vleren:**  
45.501.036,00 ( *dyzet e pesë milion e pesëqind e një mijë e tridhjetë e gjashtë* ) *lekë, pa tvsh.*
- 8. Bashkimi i operatoreve “Sterkaj”shpk, NIPT J68310708M & “Arjeil”shpk, NIPT K31320002C me vleren:**  
48.303.727,50 ( *dyzet e tetë milion e treqind e tre mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë, presje pesëdhjetë* ) *lekë, pa tvsh.*
- 9. Bashkimi i operatoreve “Alb Korça 2002” shpk, NIPT K34004003T & “Al Asfalt” shpk, NIPT K81511508A me vleren:**  
48.803.234,00 ( *dyzet e tetë milion e tetëqind e tre mijë e dyqind e tridhjetë e katër* ) *lekë, pa tvsh.*

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Bashkimi i operatoreve “Ina ” shpk, NIPT J61814009W & “2N” shpk, NIPT L31615017L per arsye se:**

Nuk plotëson kriterin e vendosur në DST, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit , pika 2.2 **Aftësitë teknike dhe profesionale**, pika 2.2.1 ku përcaktohet shprehimisht se :

”2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;**

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten**

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

Konkretisht shoqëria Ina sh.p.k.për vërtetimin e kriterit të mësipërm ka paraqitur kontratën me objekt "Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare Myslim Hida Arapaj Durrës" Ky objekt nuk është i ngjashëm me objektin që prokurohet.

**2. 1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne DST,shtojca 7,kriteret e veçanta te kualifikimit , pika 2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale,pika 2.2.2 ku percaktohet shprehimisht se :**

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise**

N.P. 1 A Punime gërmimi në tokë

N.P.4 A Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

N.P - 9 C Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

N.S –1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S – 18 A Punime topogjeodezike.

Konkretisht shoqëria Ina sh.p.k , në marrëveshjen e bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë 72 % të punimeve ose e konvertuar në lek 30,910,598 lek,pa tvsh.

Në liçencën profesionale të paraqitur nga kjo shoqëri rezulton se ajo është e licencuar për kategorinë N.P - 9 Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime,klasifikimi A.

Në VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi” , në lidhjen 4, është përcaktuar se klasifikimi A i korrespondon vlerës të punimeve 0-20.000.000 lek

Në kreun III ,pika 1.b të kësaj VKM-je është përcaktuar se : b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencura kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4.

Për sa më sipër referuar vlerës të punimeve që shoqëria Ina sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë ajo duhej ti ishte liçencuar për kategorinë/klasifikimin B,pra NP-9 B dhe jo A.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *Shoqërinë* “ **NIKA**”sh.p.k si përfaqësuese e bashkimit të operatorëve “**NIKA**”sh.p.k dhe “**NDERTUESI 2014**” sh.p.k, adresa e shoqërisë përfaqësuese: **Shkodër, Lagj.Vasil Shanto, Bul. Skënderbeu, godinë 8 kateshe, kati i parë, zona kadastrale 8593, nr. Pasurie 5/587**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 34.381.007,30 ( *tridhjetë e katër milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e shtatë, presje tridhjetë* ) lekë, pa tvsh, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
SOTIRAQ FILO**